



UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË

RAPORTI I PROGRESIT - MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË PËR PERIU DHËN JANAR 2018 – DHJETOR 2018

Janar 2019

Përmbledhje

Ky raport i progresit përmban të dhëna dhe rezultate nga monitorimi i zbatimit të strategjisë së UHZ-së për vitin e parë pas zhvillimit të saj, dhe përfshinë periudhën kohore janar 2018 – Dhjetor 2018

Të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit ndihmojnë në:

- Identifikimin e arritjeve të deri tanishme
- Vlerësimin e vazhdimësisë së objektivave nga viti 2017, dhe mundësisë për modifikimit e tyre
- Përcaktimin e prioriteteve për vitin 2019

Nga tridhjetë e nëntë zëra në planin strategjik, është vërejtur progres në tridhjetë prej tyre. Progresi është vërejtur në avancimin gradual të mësimdhënies duke shfrytëzuar trajnimet, kurset dhe bashkëpunimin me institucionet në vend dhe jashtë vendit. Personeli akademik edhe pse jo në nivelin e dëshirueshëm, ka avancuar gjithashtu edhe në aspektin e hulumtimeve shkencore dhe prezantimit të rezultateve në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Pjesëmarrja e UHZ-së në projekte të ndryshme në vend si dhe jashtë vendit ka ndihmuar në konsolidimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit të qëndrueshëm me institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Mund të thuhet se ka progres edhe sa i përket ngritjes së cilësisë në menaxhim.

Në përgjithësi, UHZ ka bërë një fillim të mbarë drejt realizimit të objektivave strategjike dhe ky monitorim për implementimin një vjeçar të planit strategjik ka për qëllim të ndihmojë në mbajtjen e trendit pozitiv të zbatimit edhe në të ardhmen

Monitorimi I implementimit të strategjisë ka gjetur se: përkundër faktit që UHZ duhet ti konsiderojë disa aspekte siç është përmirësimi i mëtutjeshëm cilësisë së mësimdhënies, angazhimi akoma më i madh në hulumtime shkencore si dhe në punësimin e studentëve të diplomuar në ndërmarrjet private, megjithatë nuk ka arsye që të bëjë rishikimin e strategjisë aktuale për arritjen e misionit të tij.

Të gjitha katër objektivat strategjike të për të mbeten të rëndësishme, megjithatë përfundimet e nxjerra nga ky monitorim tregojnë së fokusi I përpjekjeve si në aspektin afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë duhet të jetë në:

- Konsolidimin e programeve studimore ekzistuese si dhe zhvillimin e programeve të reja në të gjitha nivelet.
- Ri-akreditimin e Institucionit dhe programeve studimore
- Punën hulumtuese shkencore të studentëve dhe e personelit akademik.
- Kompletimin e infrastrukturës dhe funksionalizimin e kapaciteteve të tërësishme të Kampusit Universitar
- Planifikimin edhe të programeve dhe shërbimeve të tjera në kuadër të UHZ-së që janë të përshtatshme për Pejë dhe për Regjionin.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që aktualisht I ofrohen dhe jo në zgjerimin e asaj që veç është në dispozicion.

Mesazhi i përgjithshëm që del nga ky rishikim është i qartë: Universiteti Haxhi Zeka është në rrugë të mbarë dhe duke përjetuar ndryshime të rëndësishme të cilat në përgjithësi janë për të mirë

Hyrje

Në muajin Maj të vitit 2017, Universiteti “Haxhi Zeka në Pejë ka aprovuar Strategjinë zhvillimore për periudhën 2017-2022.

Në këtë dokument strategjik, është përcaktuar vizioni I UHZ që “të jetë aktor i rëndësishëm regional, që garanton zhvillim të qëndrueshëm, mësimdhënie të avancuar, inovacion, hulumtim dhe dije praktike”

Për të arritur vizionin e përmendur, universiteti ka vendosur objektiva strategjike ambicioze për avancim të mësimdhënies, hulumtimit dhe inovacionit, zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore si dhe angazhimin e vazhdueshëm në bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërinstitucional.

Ky raport është një rishikim i zbatimit një vjeçar të strategjisë pesë vjeçare dhe ka për qëllim:

- Identifikimin e arritjeve të deri tanishme
- Vlerësimin e vazhdimësisë së objektivave nga viti 2017, dhe mundësisë për modifikimit e tyre
- Përcaktimin e prioriteteve për vitin 2019

Procesi i rishikimit të zbatimit të strategjisë për vitin 2018 ka përfshirë:

- Takimet me Komisionin e emëruar për monitorimin e zbatimit të strategjisë së Universitetit
- Grumbullimin e të dhënave nga të gjitha njësitë akademike dhe organet drejtuese të Universitetit rreth zbatimit të aktiviteteve nga plani strategjik për vitin 2018
- Krahasimi i të dhënave të grumbulluara me planin strategjik për vitin 2018

Konteksti

Thelbi i një plani strategjik është identifikimi i rrugëve përmes të cilave një Institucion do të realizonte më së miri misionin e tij.

Pas rishikimit të pozicionit të UHZ-së sa i përket objektivave të vendosura në vitin 2017, ky dokument konsideron aspektet që kanë të bëjnë me modifikimin eventuale të prioriteteve apo aspiratave. Rishikimi ka gjetur se UHZ është në rrugë të mbarë drejt realizimit të objektivave të tij, (natyrisht me më shumë progres në disa fusha se sa në të tjerat) dhe se aktualisht nuk ka nevojë për ndryshimin e drejtimit të Universitetit. Megjithatë, rishikimi ka dhënë disa mesazhe që janë shfaqur rreth aktiviteteve parësore në terma afat shkurtra.

Të arriturat e deritanishme

Plani strategjik i UHZ për vitin 2018 i numëron katër objektiva strategjike në kuadër të së cilave janë shumë nën objektiva të tjera. Ky plan I punës në bazën e tij kishte objektivat e vetë strategjisë pesë vjeçare të UHZ e që janë:

1. Avancimi i vazhdueshëm në Mësimdhënie dhe të mësuar
2. Avancimi i hulumtimit dhe orientimit drejt inovacionit
3. Angazhimi i vazhdueshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstucional
4. Menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve

Në kuadër të objektivave dhe nën objektivave strategjik, plani strategjik për vitin 2018 numëronte rreth 39 aktivitete/projekte për tu realizuar përgjatë vitit 2018. Progresi është arritur në 30 nga 39 aktivitetet e planifikuara. Përditësimet e detajuara për progresin sipas objektivave janë paraqitur në shtojcat e këtij raporti

Aktivitetet kryesore të ndërmarra sipas planit për vitin 2018 përfshijnë:

- **Avancimi i vazhdueshëm në mësimdhënie dhe të mësuar**

- ✓ Studentët dhe personeli akademik kanë ndjekur master kurse, ligjërata, dhe internshipe në fushat siç janë: etika dhe mendimi kritik, këndimi koral, panaiet bujqësore, përvojat në turizëm, tatimet dhe kontabiliteti
- ✓ Personeli është trajnuar rreth mësimdhënies online (e-learning)
- ✓ Implementimi i programeve të përbashkëta me Universitet e tjera (Universitetin e Prizrenit dhe të Gjilanit)
- ✓ Ri-dizajnimi i programeve ekzistuese të niveleve Bachelor dhe Master
- ✓ Përgatitja e programeve të reja në të gjitha nivelet duke përfshi edhe nivelin PhD
- ✓ Promovimi i më të dalluarve nga personeli akademik, administrata dhe studentët
- ✓ Realizimi I projektit të tutorimit

- **Avancimi i hulumtimit dhe orientimit drejt inovacionit**

- ✓ Personeli akademik ka prezantuar punimet e tyre shkencore në konferenca kombëtare, regjionale dhe ndërkombëtare
- ✓ Universiteti ka organizuar konferencën shkencore me fokus në fushat e biznesit, agrobiznesit dhe turizmit
- ✓ Studentët marrin pjesë në akademinë studentore të muzikës
- ✓ Studentët marrin pjesë në projekte për zhvillimin regjional rural si dhe turizmit të qëndrueshëm rural
- ✓ Fakulteti I biznesit ka organizuar akademinë e studentëve për ndërmarrësi

- ✓ Universiteti ka shpallë konkursin për përzgjedhjen e punimeve më të mira shkencore të botuara në revista me impakt të lartë
- **Angazhimi i vazhdueshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstitucional**
 - ✓ Fakulteti i Agrobiznesit ka përfunduar me sukses aktivitetet në kuadër të projektit ndërkombëtar BUGI. Ekspertët e angazhuar në projekt kanë përfunduar të gjitha obligimet për mbarëvajtjen e projektit
 - ✓ Shfaqja e vlerave muzikore në bashkëpunim me Komunën
 - ✓ Mobiliteti i personelit akademik dhe studentëve ka filluar. Personeli akademik dhe studentët i shfrytëzojnë projektet për mobilitet në Universitete jashtë vendit
 - ✓ Rregullorja e për Trupat Këshillëdhënës është miratuar si dhe është hartuar Manuali operacional për Trupat Këshillëdhënës me mbështetjen e projektit EYE.
 - ✓ Komisioni për përpilimin e programit për trajnimin e personelit për të aplikuar në projekte dhe grande ndërkombëtare është krijuar
- **Menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve**
 - ✓ Zyrat për cilësi janë funksionale në Universitet dhe në të gjitha 5 njësitë akademike
 - ✓ Fakulteti i arteve është në ndërtim e sipër.
 - ✓ Ka filluar krijimi i bazës së të dhënave
 - ✓ Ka filluar zhvillimi i projektit për qasje në bibliotekat ndërkombëtare

Mjedisi I jashtëm

Numri i programeve të studimeve ka vazhduar të shënojë rritje në vend, përkundër një s'përputhje të madhe ndërmjet ofertës së arsimit dhe kërkesave të tregut të punës.

Gjatë vitit 2018, UHZ ka bërë përgatitjet për ri-akreditimin Institucional si dhe për ri-akreditimin e shumë programeve studimore në të gjitha nivelet. Financimi për arsimin e lartë në Kosovë ka shënuar rritje, kështu që edhe buxheti i UHZ-së do të jetë më i lartë gjatë vitit 2019. UHZ, ashtu si edhe institucionet e tjera publike të arsimit të lartë vazhdon të varet nga buxheti i shtetit.

Kapacitetet e administratës në institucionet publike mbeten të kufizuara. Sfidë në vete janë edhe investimet në infrastrukturë siç janë p.sh. laboratorët, hapësirat për personelin akademik etj.

Perspektiva e lëvizjes së lirë brenda kufijve të Evropës do të krijojë edhe mundësi të punësimit të rinjve edhe jashtë vendit. Prandaj, është me rëndësi që sistemi i arsimit në Kosovë t'i përshtatet kërkesave të tregut evropian të punës përmes ngritjes së cilësisë së studimeve.

Si përfundim i përgjithshëm mund të thuhet se mjedisi i jashtëm është duke ofruar disa mundësi siç është rritja e lehtë e buxhetit por në anën tjetër papunësia në vend si dhe ulja demografike mund të reflektojnë edhe në uljen e interesimit të rinjve për të ndjekur studimet e larta.

Prioritetet afatshkurtra

Gjatë konsultimeve me komunitetin e UHZ-së, është evidente që objektivat strategjike mbeten të rëndësishme.

Megjithatë, të dhënat e grumbulluara tregojnë se fokusi i përpjekjeve në afatin e shkurtër duhet të jetë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, angazhimi më i madh në hulumtime shkencore si dhe në punësimin e studentëve të diplomuar në ndërmarrjet private.

Përkundër fokusit në ri-dizajnimin dhe përmirësimin e cilësisë së kurikulave/programeve përgjatë vitit 2018, edhe gjatë viteve në vijim duhet të vazhdohet në konsolidimin e këtyre programeve si dhe zhvillimin e programeve të reja në të gjitha nivelet.

Akreditimi institucional dhe i programeve studimore duhet të jetë prioritet primar gjatë vitit të ardhshëm (2019). Prioriteti tjetër do të duhej të ishte puna hulumtuese shkencore e studentëve dhe e personelit akademik.

Përkundër arritjeve sa i përket cilësisë së mësimdhënies, objektivi duhet të jetë që të bëhet edhe më mirë.

Prioritete afatgjata

UHZ duhet ta kompletojë infrastrukturën dhe kampusi të veprojë me tërë kapacitetin e tij. Përveç programeve dhe profileve aktuale, UHZ duhet të planifikojë edhe programe dhe shërbime të tjera që janë të përshtatshme për Pejën dhe për Regjionin. Fokusi gjithashtu duhet të jetë në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që aktualisht ofrohen dhe jo në zgjerimin e asaj që veç është në dispozicion.

Përfundimet

Mesazhi i përgjithshëm që del nga ky rishikim është i qartë: Universiteti Haxhi Zeka është në rrugë të mbarë dhe duke përjetuar ndryshime të rëndësishme të cilat në përgjithësi janë për të mirë

Shtojca 1: Përmbledhje rreth zbatimit të strategjisë: Janar 2018- Dhjetor 2018

Objektivat kryesore	Numri I aktiviteteve në planin strategjik për vitin 2018	Numri I aktiviteteve ku është arritur progres
Avancimi i vazhdueshëm në Mësimdhënie dhe të mësuar	14	10
Avancimi i hulumtimit dhe orientimit drejt inovacionit	10	7
Angazhimi i vazhdueshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstytucional	8	7
Menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve	6	5
Total	38	29

Shtojca 2: Progresi në objektivin: Avancimi i vazhdueshëm në mësimdhënie dhe të mësuar

PROJEKTET/ AKTIVITET	Hapat	Veprimet e deritanishme për realizimin e objektivave	Hapat e ardhshëm
Projekti për kurse Master nga stafi ndërkombëtar	Fillimi I organizimit 2 Master klase ne këndim koral te realizohen	2 master kurse te realizuara 10 profesor 50 studnete	
	Organizimi Seminarit rreth produkteve te reja bujqësore	25 studente kane kryer internship per produktet e reja bujqësore. Fakulteti ka marre pjese ne ditën e vjeljes se boronices Aktiviteti tjetër ishte "organizimi I panairit te produkteve agro-bujqësore" I cili u organizua ne vitin 2018	
	1 ligjërata dhe 1 seminar ne fushën e etikes dhe mendimit kritik	Profesori I JMU ka marr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të organizuar nga Fakulteti Juridik dhe Arteve në Nëntor 2019.	Në programin e ri të nivelit bachelor në Fakultetin Juridik është future lënda Etika Ligjore dhe pritet në të ardhmen që të bashkëpunojmë në të ardhmen me JMU por edhe universitete tjera për të patur ligjërues mysafirë.
	1 ligjërata tematike- Përvojat amerikane ne turizëm		
	2 ligjërata nga fusha e tatimeve dhe kontabilitetit	2 ligjërata nga fushat: - "Sistemi Tatimor në Kosovë dhe zhvillimi ekonomik" - "Institucionet mikrofinanciare dhe mikrofinancat" jane mbajte me sukses	

Projekti për trajnim për mësimdhënie online (e-learning)	Përpilimi i projektit për Kompletimin e sallës Trajnimi 2 mësimdhënësve	Stafi është trajnuar për e-learning (programi module) përmes projektit t... Nga projekti EUFORIA janë siguruar Smart Board (3).	Në të ardhmen pritet nga stafi që të fillojnë të aplikojnë metodën e mësimdhënies online edhe pse mund të ketë ngadalësim në këtë proces dhe do të merr kohë.
Projekti për aplikim të metodologjive moderne në mentorim dhe në mësimdhënie	Përpilimi i projektit për trajnim të mësimdhënësve Trajnimi i mësimdhënësve	Projekti për metodologjinë e re të mësimdhënies është hartuar në bashkëpunim me një kompani angleze mirëpo ende nuk janë siguruar donacione për zbatim.	Do të kërkohen fonde për realizimin e projektit
	Organizimi i trajnimit të mësimdhënies modern dhe metodologjive	Stafi ka marr pjesë në trajnime Brenda dhe jashtë vendit mirëpo pritet realizimi i projektit të lartcekur si menyrë me e formalizuar e trajnimit.	Pritet vazhdimi i pjesëmarrjes së stafit në trajnime të tilla si dhe realizimi i projektit të lartcekur.
Hapja e programit të artit figurativ	Draftimi i programit Hapja e konkursit Mbrojtja e programit	Programi nuk është realizuar sepse është hequr këtë vit	Do të shikohet mundësia gjatë vitit të ardhshëm
Projekti për hapjen e programit master në shkencat e ushqimit	Draftimi i programit Hapja e konkursit Mbrojtja e programit	Ky aktivitet është shtyrë për vitin e ardhshëm	Vitin e ardhshëm
Projekti për ri-dizajnimin e programeve ekzistuese në nivelin bachelor	Vazhdimi i punës së komisioneve për Ri-dizajnimin e programeve Dorëzimi i tyre	Programet e studimeve Bachelor janë rishikuar dhe ri-dizajnuar nga të gjitha fakultetet	Programet janë në proces të akreditimit
Ri-dizajnimi i programeve mësimore në nivelin master	Vazhdimi i punës së komisioneve për Ri-dizajnimi programeve Dorëzimi i tyre	Programet e studimeve Master janë rishikuar dhe ri-dizajnuar nga të gjitha fakultetet	Programet janë në proces të akreditimit
Hapja e programit master në fushën e së drejtës evropiane dhe ndërkombëtare	Vazhdimi i punës së komisioneve për Ri-dizajnimi programeve Dorëzimi i tyre	Fakulteti Juridik ka aplikuar për akreditimin e këtij programi dhe këtë vit pritet vlerësimin i programit nga ekspertët	Në rast akreditimit të këtij programi do të punohet në realizimin e këtij programi.
Programi i përbashkët me Universitetin e Gjiçanit dhe atë të Prizrenit	Vazhdimi i programit	Vit i parë i përfunduar dhe fillimi në 10.2018 i vitit të dytë akademik	Gjenerata e dytë është pranuar këtë vit dhe pritet gjenerata e parë e studentëve të diplomojnë këtë vit 2019. Do të vazhdohet me pranimin e gjeneratës së tretë dhe ri-aplikim për akreditim në të ardhmen.
Klinika juridike penale-vazhdimësi	Vazhdon		
Hapja e programit të doktoraturës në fushat e biznesit dhe të ekonomisë	Draftimi i programit Hapat përgatitës Mbrojtja e programit	Programi është në proces të akreditimit	
Organizimi i ceremonisë dhe ndarja e çmimeve për profesorët dhe studentët e dalluar	Avancimi i kriterëve Shpallja Themelimi i komisioneve Përpilimi i listës së ngushte Shpallja e fituesve	Ndarja e çmimeve është bërë me datë 21/12/2018	Do të vazhdohet me ndarjen e çmimeve edhe për vitet tjera..
Hapja e programit profesional të gastronomisë	Draftimi i programit	Gjatë vitit 2018 është bërë hartimi i programit	Gjatë vitit 2019 është bërë aplikimi në AKA
Projekti i tutorimit për ngritje të kalueshmërisë në lëndë të caktuara	Identifikimi lendeve Përcaktimi i tutorëve Fillimi i tutorimit	Në fakultetin e Arteve është kryer Raporti i kalueshmërisë gjatë muajit shkurt Suksesi i procesit të tutorimit në Fakultetin e Grobiznesit ishte 55%	Do të vazhdohet me aplikimin e këtij sistemi edhe për vitet tjera.

		Ne MTHM është realizuar me sukses projekti I Tutorimit	
--	--	--	--

Shtojca 3: Progresi në objektivin: Avancimi i hulumtimit dhe orientimit drejt inovacionit

PROJEKTET/ AKTIVITETET	Hapat	Veprimet e deritanishme për realizimin e objektivave	Hapat e ardhshëm
Pjesëmarrje në projektin e zhvillimit regional rural	Vazhdimi komunikimit nder-regjional Pjesëmarrja ne takimet e përbashkëta	Gjate vitit 2018 janë mbajte dy takime nder-regjionale ne Mal te Zi, nje ne Berane dhe tjetri ne Andriovic si dhe një takim ne Peje	
Organizimi i akademisë studentore të historisë muzikore	Përgatitja e planit për akademi Ftesat Organizimi	Realizimi i suksesshëm i akademisë 50 pjesëmarrës dhe 8 studente	
Organizimi i Forumit Ndërkombëtar "Turizmi i Qëndrueshëm Rural"	Fillimi përgatitje për planin organizativ të forumit Formimi i Komitetit organizativ Shpërndarja e thirrjes për pjesëmarrje Ftesat dhe Organizimi	Ky aktivitet nuk është organizuar për shkak të mungesave ne burime njerëzore	Gjate vitit 2019 planifikohet te zevendesohet me nje mobilitet te perafert
Projekti për rifillimin e botimit të revistës multi-disiplinare shkencore	Hartimi hapave te rrugës dhe projektit për Revistën Themelimi I Bordit Shkencor Ndërkombëtar	Janë mbajtur dy konferenca shkencore për të cilat janë krijuar borde shkencore si dhe janë publikuar libra te abstrakteve. Krijimi i revistës shkencore është shtyre për të ardhmen sepse është menduar të organizohen fillimisht disa Konferenca Ndërkombëtare Shkencore për te krijuar përvoja dhe pastaj te krijohet revista.	Do te shikohet në të ardhmen a te shkohet me një revista apo disa revista te tilla edhe pse motivi për revistat te tilla nuk është i larte pasi qe nuk vlerësohen për avancimin e stafit.
Projekti konferencës vjetore në fushat juridike	Identifikimi I fushave specifike Krijimi I Komitetit Organizativ Shpallja e thirrjes Ftesat dhe organizimi		
Projekti për hapjen e Instituteve të Hulumtimeve, në fushat e biznesit dhe turizmit dhe shkencave Juridike	Themelimi I Komisionit për funksionalizim Përpilimi i Rregullores për Institute ne njësi Themelimi organeve udhëheqëse Fillimi i punës se Institutit		

Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare në fushën e ekonomisë dhe të biznesit	Përcaktimi i temave Shpallja e ftesës për pjesëmarrje Organizimi Konferencës	Konferenca është organizuar me sukses gjate vitit 2018. Pjesëmarrja ishte masovike	
Projekti Akademisë së Studentëve për Ndërmarrësi	Përgatitja e kushteve për pjesëmarrje Krijimi i grupit bartës Përcaktimi i kritereve Shpallja Organizimi i Akademisë	Organizimi i akademisë së studentëve, 3 çmime te ndara për ndërmarrësit e rinj me te mire potencial	
Projekti për themelimin dhe Funkcionalizimin e Institutit Hulumtues në Agrobiznes	Themelimi i Komisionit për funksionalizim Përpilimi i Rregullores për Institute ne njësi Themelimi organeve udhëheqëse	Është themeluar komisioni për përpilimin e rregullores për themelimin e Institutit.	Krijimi i rregullores për Institut është shtyre për shkak te projektit funksional te përbashkët me Mitrovicën dhe partneret e tere
Konkursi i përzgjedhjes së punimeve të botuara në revista të indeksuara shkencore dhe ndarja e shpërblimeve	Njoftimi për Konkursin për punime shkencore Krijimi Komisionit vlerësues ne nivel UHZ	Zgjedhja e tre punimeve me te mira është realizuar	Pritet te aplikohet si proces edhe ne te ardhmen

Shtojca 4: Progresi në objektivin: Angazhimi i vazhdueshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstitucional

PROJEKTET/ AKTIVITETET	Hapat	Veprimet e deritanishme për realizimin e objektivave	Hapat e ardhshëm
Projekti për rrjetëzim të Fakultetit të Agrobiznesit	Identifikimi i partnereve Finalizimi i marrëveshjeve Plani i veprimit	Fakulteti i Agrobiznesit ka përfunduar me sukses aktivitetet ne kuadër te projektit ndërkombëtar BUGI Përpos vizitave ne Itali, Gjermani, Slloveni dhe BeH, ekspertet a angazhuar ne projekt kane përfunduar te gjitha obligimet për mbarëvajtjen e projektit	Vazhdon anëtarësimi i UHZ-se ne ENAI.
Projekti për shfaqjen e vlerave muzikore të UHZ	Përgatitja e planit për mbajtjen e Koncertit Identifikimi i pjesëmarrësve Realizimi	Ne mbështetje te Komunës se Pejës është mbajtur koncerti ku morën pjese 20 profesorë, 50 studentë dhe 150 shikues	
Mobiliteti i stafit dhe i studentëve të UHZ-së	Identifikimi i nevojave sipas fushave për mobilitet Kriteret për perzgjedhje Përzgjedhja Starti mobilitetit	Është krijuar grupi punues për ofrimin e ndihmës studentëve për plotësimin e aplikacioneve për studime jashtë vendit dhe për pjesëmarrje në aktivitet tjera; Kontaktet e grupit punues janë dërguar tek studentët përmes webfaqes. Grupi ka pranuar një numër modest të kërkesave nga studentët por si rezultat është pranuar një studentë për studime në Hungari dhe një studente në Amerikë për një program edukativ. Tre profesor kane qene ne mobilitet përmes ERASMUS ne Poloni.	Pitet te vazhdoj punën grupi dhe stafi te aplikoj për mobilitet tjera. Ne maj pritët pjesëmarrja e 4 profesorëve për mobilitet ne Poloni.

Projekti për promovimin e bashkëpunimit UHZ-Biznes	Aprovimi Rregullores se re për trupa Këshillëdhënëse Kompletimi i Trupave Përgatitja e planit te veprimit ne bashkëpunim me biznese	Është miratuar Rregullorja e për Trupat Këshillëdhënëses si dhe është hartuar Manuali operacional për Trupat Këshillëdhënëses me mbështetjen e projektit EYE.	Fakulteti Juridik dhe Arteve janë ne përfundim te procesit te krijimit te këtyre trupave
Projekti për themelimin e Qendrës Këshillimore për Sektorin e Agrobiznesit	Ngritja e Komisionit për themelim dhe identifikimin te fushave për këshillim Përpilimi I akteve për funksionim te qendrës Funksionalizimi	Eshte shtyre per vitin e ardhshem	
Trajnimi stafit për aplikim në projekte dhe grante ndërkombëtare	Themelimi Komisionit Përpilimi I programit te trajnimeve Identifikimi I fushave Identifikimi pjesëmarrësve Organizimi i trajnimit	Komisioni eshte takuar. Jane krijuar prioritetet ne baze te nevojave te UHZ-se	Trajnimet do te behen gjate vitit 2019
Këshillim dhe trajnimi studentëve për aplikim në fonde ndërkombëtare	Ngritja e Grupit për mbështetje studenteve për aplikim Përgatitja e agjendës per këshillim dhe trajnime te studenteve Organizimi i trajnimeve .këshillimeve dhe ditëve informuese	Është krijuar grupi punues për ofrimin e ndihmës studentëve për plotësimin e aplikacioneve për studime jashtë vendit dhe për pjesëmarrje në aktivitet tjera: Kontaktet e grupit punues janë dërguar tek studentët përmes weebfaqes. Grupi ka pranuar një numër modest të kërkesave nga studentët por si rezultat është pranuar një studentë për studime në Hungari dhe një studente në Amerikë për një program edukativ.	Studentet mund te kontaktojnë grupin edhe ne te ardhmen
Aktivitetet të ndërlidhura me bashkëpunimin dhe zhvillimin e UHZ	Identifikimi I fushave te nevojshme për avancim te nivelit akademik te UHZ Rrjetëzimi Shkëmbimi akademik Pjesëmarrja ne ngjarje shkencore dhe akademike	Stafi ka marr vazhdimet pjese ne konferenca shkencore dhe një pjese e tyre është financuar nga veta ata dhe ne disa raste nga vet UHZ. UHZ është anëtarësuar ne ENAI dhe BUA.	UHZ do te vazhdoj me këto aktivitetet edhe ne te ardhmen.

Shtojca 5: Progresi në objektivin: Menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve

PROJEKTET/ AKTIVITETET	Hapat	Veprimet e deritanishme për realizimin e objektivave	Hapat e ardhshëm
Projekti për zhvillimin e ekonomisë lokale, i fokusuar në prodhimet vendore dhe në agro-turizëm	Identifikimi sektorëve zhvillimor te nivelit local Identifikimi I llojeve te veqanta-frutave te imte Involvimi studenteve ne projekt	3 lloje te fruatve te identifikuar 30 studente pjesemarrres	
Funksionalizimi i zyravetë cilësisë	Ngritja dhe funksionalizimi i zyrës qendrore për cilësi dhe nominimi I personave përgjegjës për cilësi ne njësi akademike	Në 2018. Zyrë funksionale per cilësi ne nivel UHZ dhe ne 5 njesite akademike	

Krijimi i bazës së të dhënave (databazës) përmbledhje të informatave dhe të dhënave	Krijimi dhe funksionalizimi i GP për krijimin e databazës Lista e të dhënave për databazë Fillimi i grumbullimit të dhënave Funksionalizimi i databazës	Grupi për krijimin e bazës së të dhënave (databazës) për mbledhje të informatave dhe të dhënave për UHZ, është themeluar dhe janë duke plotësuar databazën në formë të excel dhe pritet që këtë vit të shikohet mundësia e krijimit të një forme më të avancuar të saj.	Grupi punues do të vazhdojë punën dhe do të shikohet mundësia e avancimit të databazës
Projekti i hartimit të Planit për zhvillim të vazhdueshëm të personelit	Krijimi GP për hartimin e Planit Draftimi i Planit Aprovimi i planit Implementimi	Grupi ka hartuar Planin për Zhvillimin e stafit akademik dhe i njëjti është publikuar në faqe të UHZ	Planin pritet të përditësohet vazhdimisht dhe të zbatohet sipas mundësive buxhetore
Ndërtimi i objektit të Fakultetit të Arteve	Vazhdimi i Ndërtimit, Përfundimi i punimeve të vrazhda	Punimet në pjesën e vrazhdeve pjesërisht përfunduara në vitin 2018	Punët në ndërtim janë duke vazhduar
Ndërtimi i objektit të Fakultetit të Sporteve	NA	NA	Shtyhet për shkak të pamundësisë së realizimit në këtë periudhë
Projekti për qasje në Bibliotekat Elektronike	Identifikimi i botuesve relevant Kontaktimi i tyre Nënshkrimi i marrëveshjeve Funksionalizimi i bibliotekave elektronike	Sa i përket Projektit për qasje në Bibliotekat Elektronike, është hartuar lista me databazë dhe kontakte por anëtarësimet me pagesa janë vështirë për tu realizuar për shkak të pamundësisë buxhetore të kufizuara të anëtarësimet. Disa baza të revistave open source janë të listuar në këtë databazë.	